



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0111**  
**Data e Vendimit: 24.02.2025**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr.01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Internat Security Association" SH.P.K kundër vendimit për aktivitetin e prokurimit: “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 24.02.2025, mori këtë:

## Vendim

**I. Hedhet si e parakohshme**, ankesa e OE "Internat Security Association" SH.P.K. me nr. të protokollit 2025/0111, e datës 11.02.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, i inicuar nga Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

**II.** I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

## Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 11.02.2025, ka pranuar ankesën e OE "Internat Security Association" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, të Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 25.09.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë. Me datën 29.01.2025 AK ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara ku hapja e ofertave është planifikuar me datën 11.02.2025 në ora 14:00.

Operatori Ekonomik "Internat Security Association" SH.P.K, me 11.02.2025, ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 2025/0111 (Nr. protokolli).

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, me datën 25.09.2024 është publikuar në sistemin e-prokurimi njoftimi për kontratë ndërsa me datën 29.01.2025 AK ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara ku hapja e ofertave është planifikuar me datën 11.02.2025 në ora 14:00.

Me datë 11.02.2025, OE "Internat Security Association" SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokolli 2025/0111.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, konstatohet se operatori ekonomik ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 17.10.2025 kundër formularit për korrigjimit të gabimeve të mëhershme dhe ka pranuar vendimin për kërkesën për rishqyrtim të AK-së me datë 22.10.2025 ndërsa ndaj formularit të fundit të datës 29.01.2025 nuk figuron në sistemin E-Prokurimin që OE paraprakisht i është drejtuar AK-së me kërkesë për Rishqyrtim

OSHP konstaton se OE nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK por ka parashtruar direkt ankesë në OSHP. Nga kjo konstatohet se OE ka parashtruar ankesë të parakohshme për faktin se sipas nenit 109 të LPP-së operatori ekonomik mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së vetëm pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim në Autoritet Kontraktues.

OSHP sqaron se sipas nenit 109 të LPP-së kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu, edhe me nenin 64 par 1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohet se: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të palejuar sepse nuk ka respektuar dispozitat ligjore të shtjelluara si më lartë, andaj i lejon autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.





**Agim Sheqiri**  
U.D. Kryesues i Sekretariatit

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - "Internat Security Association" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: